VENDIM
Nr. 631, datë 26.10.2018

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 629, DATË 15.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në manualin nr. 3, "Analiza teknike për punimet e rrugëve, kullim-ujitje dhe hidrocentraleve", bashkëlidhur vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet tabela "Analiza: An-1", sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila implementohet fillimisht në punimet e rrugëve të kategorive C, D, E dhe F.

2. Ky vendim i shtrin efektet për projektet, të cilat fillojnë të zbatohen pas hyrjes në fuqi të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

MANUALI 3

ANALIZA TEKNIKE PER PUNIMET E RRUGEVE, KULLIM - UJITJE DHE HIDROCENTRALEVE

(Përmbledhëse e çmimeve)

NR.	NR. ANALIZE	E M E R T I M I	NJESIA	ÇMIMI	Shpenzime te pergjith. Max. 8%	Fitimi Max. 10%	TOTALI
1	An-1	Stabilizim bazamenti rruge t=20 cm (metode alternative)	m2	**1,519**	121	152	**1,792**

Analiza: An-1

Nr. Analize	E M E R T I M I	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp pl 8%	Fitim 10%	TOTALI
			op	çmimi	Vlefta	T/km	çmimi	Vlefta	o.p	çmimi	Vlefta	Sasia	çmimi	Vlefta				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	**16**	17	18	**19**
An-1	**Stabilizim bazamenti rruge t=20 cm (metode alternative)**	**m2**																
	Sp + p	op	0.05	185	9													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	9	0.167	2													
	Grejder	op							0.01	4500	23							
	Autocisterne (per sperkatje aditivi)	op							0.001	3000	3							
	Makineri per perzierje shtresa Buldozer S-80/100 KF	op							0.03	4800	120							
	Rul (cilinder) me dhembe	op							0.01	2200	11							
	Rul me kompresor	op							0.01	1770	9							
	Aditiv organik (per kompaktesim)	m2										1	1305.18	1305				
	Argjile	m3				1.5	18	27.0				0.036	285	10				
	Shuma				**11**			**27.0**			**165**			**1315**	**1519**	121	152	**1792**